



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.277/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj-kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ismet Imeri, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, nga rradhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Klinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR (Pasafatshme) ankesa ZL.Anr.277/2025, datë 20.10.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, Ismet Imeri, nga rradhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Klinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, Ismet Imeri, nga rradhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se ka dyshime për parregullsi në numërimin e votave në palestrën sportive në Klinë, më datën 15.10.2025 gjatë ditës 08:00-16:00 gjatë numërimit ka pasur individ që kanë lobuar për kandidat të caktuar brenda PDK-së dhe të njëjtit individ kanë numëruar vota të kandidateve dhe se këta individ kanë regjistruar apo rritur numrin e votive për kandidat të caktuar duke më demtuar mua.

Më tej në ankesë, parashtruesi i ankesës kërkon rinumërim të votave në shkollat: “Fehmi Agani”, “Ismet Raci”-Klinë, “Shtjefen Gjeçovi”-Zllakuqan, “Tre Dëshmorët”-Jashanicë dhe shkollën “Avni Zhabotu”-Shtupel.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e

numërimin në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Kqz, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Klinës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si ne vijim: *“Me aktivitetet e punës në Qendrën Komunale e Numërimit (QKN), Palestra Adem Jashari në Klinë kemi filluar me datën 13.10.2025, më ndërrimin e dytë prej orës 16:00 dhe kemi vazhduar për tre ditë rresht deri me 15.10.2025, në ndërrimin e parë të së mërkurës ka përfunduar i gjithë aktiviteti i numërimit”*. Sipas vlerësimit të KKZ-së, numërimi ka kaluar në rregull dhe pa asnjë vërejtje nga palët përveç një ankesë. Pretenduesi njëherë është drejtuar më ankesë tek ne, me faktin se ne nuk e pranuan si të tillë ka vazhduar dhe në organet tjera si në polici dhe PZAP në theks të veçantë për kutinë 0807/01, numëruar nga tavolina nr.2, pas shfaqjes së rezultateve në ekran, ka pasur pakënaqësi për numërimin e votave të kandidatëve. Ne si KKZ kemi analizuar rrethanat dhe kemi sugjeruar të numërohen dhe njëherë votat për kandidat të subjekti përkatës, për të cilën kuti të vendvotimit 0807/01 ishte e hapur dhe vërehen dallime në rezultatin për vota të kandidatëve dhe të cilat dallime janë azhurnuar në total. Pas kësaj pretenduesi hap dyshime edhe për kuti të tjera si 0805/01 me të dëgjuar se këtë vendvotim e ka trajtuar hetuesia në ditën e zgjedhjeve më 12.10.2025 ndërsa për kutinë 0805/02 nuk kemi informacione e as të dhëna për çfarë arsye është trajtuar në ankesë. Lidhur me pretendimet e palëve ankuese për mospërputhje të rezultatiit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesave është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkangjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore. Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Të bashkangjitur kësaj përgjigje në kërkesë janë:

- Raporti i aktiviteteve të punës në QKN, në Klinë;
- Formularët 0805/01, 0805/02 dhe 0807/01.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e palejuar (pasafatshme).

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 20.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi lidhur me numërimin të votave.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.10.2025, në ora 10:15, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 15.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, Ismet Imeri, nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të parregullsive në numërim të votave, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.277/2025, datë 22.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.